



Në bazë të nenit 5, paragrafi 2 të Rregullores nr. 05/2025 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

## Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Ofrues i Shërbimeve – Shef i Inkasantëve
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	12 muaj
<b>Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit</b>	600.00 Euro
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	03.04.2026
<b>Afati për aplikim</b>	14.04.2026
<b>Institucioni</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Koordinimit Rajonal
<b>Divizioni</b>	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 N.SH “Tregu”
<b>Vendi i punës</b>	NSH “Tregu” PRN104 – Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	14.04.2026 – OSH Shef i Inkasantëve

### 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Organizimin dhe mbikëqyrjen e punës së inkasantëve në tri tregjet (RTK, Ulpianë dhe Zona Industriale);
- Hartimin dhe koordinimin e orareve të punës së inkasantëve;
- Mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes së faturave dhe inkasimit të pagesave;
- Kontrollin dhe verifikimin e evidencave financiare të inkasimit;
- Pranimin dhe kontrollin e parave të imta të inkasuara;
- Kryerjen e barazimit ditor të inkasimit me inkasantët;
- Sigurimin e dorëzimit korrekt të mjeteve financiare tek financieri;
- Monitorimin e disiplinës së pagesave nga qiramarrësit;
- Raportimin periodik tek Zyrtari i Rastit dhe Autoriteti i Likuidimit;
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

### 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Shkollë e mesme (minimumi i kërkuar);
- Njohuri të mira pune me pakon e programeve Microsoft Office;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikimi;
- Saktësi dhe përgjegjësi në kryerjen e detyrave.

### 4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi;
- Minimum 2 (dy) vite përvojë pune në fusha relevante (administratë, financa, inkasim, menaxhim operacional apo të ngjashme);
- Njohja e proceseve të inkasimit dhe evidencave financiare konsiderohet avantazh;

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### 6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara, siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit;
- FORMULARI I APLIKIMIT - formularin mund ta shkarkojnë në Ueb Faqen e AKP-së. (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>), [DAADE23B-4E75-4DF9-8043-E7F5FE5B5CB0.doc](https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33) Shkarko Aplikacionin
- Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë përfshirë edhe ato të dorëzuara me postë nuk pranohen, dhe aplikacionet e pa kompletuara refuzohen.
- Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe i lexueshëm;
- Pranimi i aplikacioneve nga kandidatët për pranim bëhet brenda SHTATË (7) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit
- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 14.04.2026 në ora 16:00 në emalin [punesimi@pak-ks.org](mailto:punesimi@pak-ks.org) apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

### 7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 14.05.2026, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).



## 8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-